

KËRKESË
Nr. 1625, datë 27.5.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT “COLOMBO SHPK”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimin përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- **“COLOMBO SHPK”**

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2018-000083-5

Datë: 21.1.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2018-000083-2, datë 21.12.2018, inspektim, që është zhvilluar në subjektin COLOMBO, NIPT K36608208V, punëdhënës Petrit Leventi, prej datës 21.12.2018, ora 09:00 deri më datën 21.12.2018, ora 15:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 21.12.2018 dhe e njoftoi në datën 21.12.2018.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, 29, 1/b/ii,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, nenit/neneve 29, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 300 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Plotësimin e dokumentacionit të munguar dhe paraqitjen e tyre pranë ISHMPUT-së Tiranë.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Genci Hicka ID: 0301020016

Eni Guce ID: 0301020026

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti COLOMBO ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.